



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 592/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga Ferit Osmani kryesues, Vllastimir Dimic dhe Nehat Idrizi anëtarë, përkatësi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) paraqitur kundër komisionereve Rizah Beqiri anëtar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë (LDD) dhe Sabri Gashi anëtar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), në lidhje me parregullsi gjate procesit zgjedhor, në seancën e mbajtur më 15.12.2010, mori:

VENDIM

HIDHET poshtë si e palejuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV)

ARSYETIMI

Më datë 13.12.2010 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga LVV paraqitur përkundrejt komisionereve të LDD-se dhe LDK-se, respektivisht Rizah Beqiri dhe Sabri Gashi, në të cilën pretendohet se “me datë 12.12.2010 në shkollën fillore “Mustafe Venhari”, Vushtri, llampa nuk punon por Rizah Beqiri (LDD) ka lejuar që në sallën 2704B/07R persona të ndryshëm të votojnë nga dy here; Dr. Avdullah Vojvoda me një grup personash ishte në oborrin e shkollës pa arsye për të bërë presion tek vëzhguesit e LVV-se; Sabri Gashi (LDK) ka penguar të votojë i lirisht dhe ka bërë presion ndaj votuesit Qazim Sadiku, me qëllim që ky të votojë për LDK”.

Në mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë, përveç se ka siguruar numrin e telefonit të Sabri Shytit, në rolin e dëshmitarit.

Neni 59 paragrafi 2 i LKP-së, specifikon si më poshtë:

59.2 KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji;

Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, neni 6.4 (Vendimet për Ankesat) parasheh si vijon:

6.4 *“Panelet mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo at të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie”.*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e palejuar

PZAP-i vlerëson se ankesa e LVV-se paraqitur përkundrejt komisionereve të LDD-se dhe LDK-se, është jashtë juridiksionit të PZAP, për shkak se KQZ është organi i cili merret me funksionalizimin dhe organizimin e zgjedhjeve duke përfshirë edhe përdorimin e detektorëve gjatë procesit të zgjedhjeve, fakt ky që konfirmohet nëpërmjet Rregullës Zgjedhore Nr. 09/2009. Prandaj për këtë arsye dhe në pajtim të dispozitave ligjore të cekura më lartë si dhe në pajtim të nenit 115.1 të LQP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LQP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 592/2010 më datën 15.12.2010.

